



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT

MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR

NË BASHKINË DURRËS

SHTATOR 2019



GJETJE NGA RAPORTI I VLERËSIMIT
MBI PRAKTIKAT E MEKANIZMIT TË BUXHETIMIT ME
PJESËMARRJE DHE KONSULTIMIT NË NIVEL VENDOR
NË BASHKINË DURRËS

SHTATOR 2019



GJETJET - BASHKIA DURRËS

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Si rezultat i Reformës Administrative Territoriale të vitit 2015, Bashkia Durrës përfshiu në juridiksionin e saj dhe 5 ish-komuna (sot njësi administrative). Në vitin 2015 numri i popullsisë ishte 214.559 banorë dhe sipërfaqja 46.1 km². Numri i banorëve sot është 323.147, kurse sipërfaqja teritoriale 341.9 km². Bashkia e Durrësit renditet e dyta në rang kombëtar përsa i përket numrit të popullsisë dhe e dyta për nga rëndësia ekonomike. Sot Bashkia e Durrësit përbëhet nga 6 njësi administrative: Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz, 3 qytete dhe 40 fshatra. Vetë qyteti i Durrësit ka 6 rajone dhe 14 lagje.

STAFI I BASHKISË

Për përgatitjen e këtij raporti, u pyetën 10 punonjës të Bashkisë Durrës, të cilët përfshijnë: staf drejtues dhe specialistë nga Drejtoria e Financës, Shërbimit Social, Urbanistikës, Investimeve, Politikave të Zhvillimit, Punëve Publike, Zyra e Koordinim Zhvillimit, Sektori i Projekteve, si dhe Koordinatorja e Transparencës, Koordinatorja e Informimit dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak. Vlen për t'u theksuar që të gjithë të intervistuarit përfaqësojnë drejtoritë që janë të përfshira në procesin e BP.

- Sipas 80% të të intervistuarve, Bashkia Durrës ka mekanizma të pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët dhe BP është një prej tyre. Të tjerë mekanizma që veçohen nga të intervistuarit janë dëgjesat për programin buxhetor afatmesëm, për plane e strategji sektoriale, të tilla si, Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, zbatim projektsh me fonde të BE apo të tjera të huaja. Sipas një nga të intervistuarve, Bashkia Durrës ka krijuar procese monitorimi të planeve të cilat detyrimisht kërkojnë pjesëmarrjen qytetare.
- Sipas burimeve zyrtare BP ka nisur të zbatohet në Bashkinë Durrës që nga viti 2007. 70% e punonjësve të intervistuar të Bashkisë mendonin që procesi kishte mbi 3 vjet që zhvillohej. Në lidhje me pyetjen se kush ka nisur për herë të parë si proces, 30% e tyre mendonte se është iniciuar nga Kryetari dhe administrata e bashkisë dhe 70% nga donatorët apo organizatat e shoqërisë civile.
- Të pyetur nëse ka vendime apo rregullore të miratuara nga KB apo Kryetari i Bashkisë, 50% e të intervistuarve u përgjigjën pozitivisht dhe pjesa tjetër nuk ishin në dijeni ose dhanë përgjigje negative, duke nënkuptuar si të tillë kalendarin e dëgjesave dhe miratimin nga Kryetari i Bashkisë të urdhërit të brendshëm për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS). Këta të fundit deklarojnë si arsye kryesore të mungesës së dokumentacionit përkatës mospasjen e një praktike për t'u përshtatur në Bashkinë Durrës. Nga burimet pranë Bashkisë Durrës u informuam që ka një procedurë të brendshme për zbatimin e procesit të BP të hartuar nga Partners Albania me mbështetje të Olof Palme International Center dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, me të cilën është punuar vitet e fundit, por nuk vihet re përfshirja e Këshillit në të gjithë hapat e tij.

- Stafi i Bashkisë Durrës në përgjithësi ka dijeni për organizimin e procesit BP dhe hapat e ndërmarra në të, por vërehet që në referimin specifik ka konfuzion për etapat dhe përfundimin e procesit. Asnjë i intervistuar nuk flet për institucionalizimin e procesit nga KB. Nga përgjigjet lihet të kuptohet që mungon një praktikë e mirëpërcaktuar që do të lehtësonte procesin nga nisja deri në përfundimin të tij.
- I njëjti konfuzion vërehet edhe në përgjigjet e marra për strukturën përgjegjëse për organizimin e BP-së, të cilat variojnë nga titullari i institucionit dhe deri tek organizatat e shoqërisë civile. 40% e të intervistuarve mendojnë që struktura përgjegjëse është Drejtoria e Zhvillim Koordinimit dhe 20% e mendojnë si përgjegjësi të tre drejtorive së bashku: asaj të Zhvillim Koordinimit, Financave/Buxhetit dhe GMS. Stafi i Bashkisë Durrës e mendon këtë proces si gjithëpërfshirës dhe të gjithë të intervistuarit deklarojnë që të gjitha drejtoritë përfshihen në të.
- Po kështu të gjithë të intervistuarit kur pyeten për mjetet e njoftimit dhe përfshirjen qytetare në këtë proces raportojnë se lajmërimet përmes mediave sociale, mediave lokale dhe afishimi në ambjentet e bashkisë ishin mënyrat më të përdorura nga Bashkia. Ndërkohë që 50% e tyre u shprehën që regjistri elektronik nuk përdorej asnjëherë e pjesa tjetër që lajmërimet individuale dhe njoftimet në gazetën lokale përdoren ndonjëherë.
- Të gjithë të intervistuarit përmendin si mjetet më efektive për sigurimin e të gjitha grupeve të synuara faqen zyrtare dhe faqen e Facebook-ut të bashkisë, TV lokale dhe njoftimin individual nëpërmjet administratorëve, por në asnjë rast nuk përmendet ndërlidhësi komunitar. Ndërkohë që të intervistuarit mendojnë që ka nevojë për përmirësim të këtij procesi duke theksuar nevojën për trajnime lidhur me fuqizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit dhe rolin e mediave në të.
- Vetëm 20% e të intervistuarve mendonjnë që ka një regjistër elektronik dhe vetëm 10% e tyre shprehën që regjistri publikohet online. Nga një verifikim i thjeshtë online nuk ka asnjë regjistër të tillë të publikuar. Asnjë prej tyre nuk kishte dijeni se cila është struktura përgjegjëse për përditësimin e tij, dhe po ashtu asnjë prej të intervistuarve nuk kishte dijeni për funksionimin dhe përditësimin e këtij regjistri.
- Sipas të intervistuarve mungojnë statistikën në lidhje me numrin e qytetarëve të përfshirë në BP apo të dhënave të tjera të ndara sipas kategorive (gjini, moshë, biznese, të rinj, njerëz në nevojë, etj), edhe pse për shumë vite procesi është bashkëkoordinuar me organizata të shoqërisë civile, të cilat kanë kapacitete për monitorimin e këtij procesi të paktën edhe përmes listave të pjesëmarrësve.
- Duket se monitorimi dhe vlerësimi i proceseve vijon të mbetet sfida për bashkitë në vend. Edhe në Bashkinë Durrës nuk ka një sistem të tillë pasi 90% e të intervistuarve e konfirmojnë këtë ose nuk kanë dijeni nëse ka një të tillë për procesin e BP. Vërehet

sërisht konfuzion midis procesit BP dhe atij të programit buxhetor afatmesëm të bashkisë, i cili është parë me prioritet me hyrjen në fuqi të Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore.

- Punonjësit e Bashkisë Durrës vlerësojnë si sfidën kryesore qytetarin dhe punën me të. Ata shprehen për pjesëmarrje të ulët të grupeve të interesit, grave, të rinjve, komuniteteve të marxhinalizuara, e sidomos në zonat rurale. Gjithsesi ata shprehen se përmes procesit të BP është rritur interesi i qytetarëve për të marrë pjesë dhe dhënë mendimin e tyre, por nuk vlerësojnë rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në të gjitha etapat e BP. Po ashtu punonjësit e intervistuar nuk japin mendim në lidhje me format e rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve.
- Të pyetur për nevojat e përmirësimit të këtij procesi, stafi i Bashkisë Durrës mendon që ato lidhen me rritjen e kapaciteteve, përmirësimin e burimeve financiare e njerëzore dhe sigurimin e infrastrukturës së duhur për realizimin e këtij procesi. Më konkretisht, 60% e tyre përmendin asistencën teknike dhe trajnimet, 50% mendon që ka nevojë për përmirësim të burimeve njerëzore, 50% të burimeve financiare dhe 40% infrastrukturë e përshtatshme.

KËSHILLI BASHKIAK

Pas zgjedhjeve vendore 2015, Këshilli Bashkiak numëronte 51 këshilltarë vendorë, nga të cilët 26 gra (51%) dhe 25 burra (49%). Këshilli i ri Bashkiak i dal si rezultat i zgjedhjeve lokale të mbajtura në 30 qershor 2019 ka në përbërjen e tij 51 anëtarë (48 aktualisht), nga të cilët 25 gra (52%) dhe 23 burra (48%), kryesisht të forcës së majtë. Këshilli Bashkiak Durrës nuk ka një Aleancë të Grave Këshilltare.

Për përgatitjen e këtij raporti, u pyetën 10 ish-anëtarë të Këshillit Bashkiak Durrës.

- Këshilltarët e pyetur e vlerësonin si shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset konsultuese, duke vënë theksin në transparencën dhe politikbërjen cilësore. Sipas të intervistuarve siguri i pjesëmarrjes qytetare është detyrim ligjor, por po kaq e rëndësishme është edhe për veprimtarinë e çdo individi të Bashkisë Durrës. Vetëm një këshilltar mendon se vendimet që merren në Këshill janë politike dhe pjesëmarrja qytetare mbetet në hije.
- Baza ligjore referuese njihet nga këshilltarët edhe pse në përgjigjet e tyre vërehet referim në akte ligjore të ndryshuara apo të shfuqizuara. Gjithsesi, të intervistuarit deklarojnë se janë trajnuar për decentralizimin dhe vetëqeverisjes vendore. 80% e tyre deklarojnë që legjislacioni është i qartë dhe i plotë dhe 20% përgjigjen që është i qartë, por jo i plotë.
- Në përgjithësi, kur pyeten për rregullore apo procedura të miratuara të BP, pjesa më e madhe e këshilltarëve deklarojnë se nuk kanë dijeni nëse këto dokumenta ekzistojnë,

por 20% e tyre përgjigjen që ka një procedurë të brendshme të bashkisë, të cilën nuk e kanë në dispozicion.

- Përsa i përket bashkëpunimit mes KB dhe Bashkisë për procesin e BP-së, këshilltarët përgjigjen në forma të ndryshme, duke renditur: marrjen e ftesave nga stafi bashkisë për takimet e konsultimet publike, e cila realizohet nëpërmjet Komisionit të Ekonomisë; konsultime publike që kryhen për projekte të mëdha investimesh apo thjesht prezantimin në Këshill nga Komisioni i Ekonomisë të projekteve dhe nevojave prioritare të dala nga takimet.
- Pyetjes mbi format dhe mjetet që përdor Bashkia për njoftimin e procesit të BP, të intervistuarit vlerësojnë si formën më të përdorshme postën elektronike (e-mail) dhe lajmërimin publik të afishuar në ambientet e Bashkisë (70%). Më pas, përmendin lajmërimet në mediat sociale dhe regjistrin elektronik (20%). 10% e tyre njohin vetëm lajmërimin publik të afishuar në ambientet e Bashkisë.
- Të pyetur për ekzistencën e një mekanizmi monitorimi dhe raportimi të BP, 90% e këshilltarëve përgjigjen që nuk ekziston një i tillë. Pra, pavarësisht se kanë njohuri për konsultimet që Bashkia organizon, ky proces nuk monitorohet në Këshill. Dhe po kështu mungon raportimi specifik për procesin e buxhetimit me pjesëmarrje. Këshilltarët përgjigjen që rekomandimet e dala nga procesi BP përfshihen në projektbuxhet dhe nuk raportohen më vete. Por kur pyeten për miratimin e projekt-akteve të BP, vërehet paqartësi, pasi 30% e këshilltarëve thonë që ato miratohen të përfshira në projektbuxhetin e propozuar nga Bashkia, 40% si pikë e veçantë në mbledhjen e KB dhe 30% e tyre nuk kanë dijeni.
- Si rrjedhojë, edhe pyetjes a ndiqet zbatimi i vendimeve të BP, të intervistuarit i përgjigjen sërish me paqartësi, pasi 40 % e këshilltarëve deklarojnë që ndjekin zbatimin e vendimeve, 30% e tyre raportojnë që zbatimi vendimeve nuk ndiqet fare dhe po kështu 30% që nuk kanë dijeni.
- Pothuajse të gjithë këshilltarët e intervistuar kanë dijeni për mekanizmat që sigurojnë pjesëmarrjen dhe konsultimin me qytetarët për veprimtarinë e KB. Si më efektive ata rendisin seancat dëgjimore të Këshillit Bashkiak dhe BP. Më pas këshilltarët rendisin si mekanizma të tjerë të rëndësishëm konsultimet me ekspertë dhe mediat sociale e platformat online.
- Të pyetur në lidhje me aktet dhe dokumentat e miratuara dy vitet e fundit për të cilat janë kryer konsultime me publikun, të gjithë të intervistuarit shprehën se vendin e parë e zënë konsultimet për planet strategjike afatmesme dhe buxhetin vjetor të bashkisë (60%). Ndërkohë që 20% e këshilltarëve përgjigjen që konsultimet me publikun janë organizuar për të lançuar dhe promovuar projektet, pasi zbatimi tyre nuk është ndjekur më pas.

- Sipas përgjigjeve të marra rezultojnë që këshilltarët i njohin mënyrat e matjes së kënaqësisë së qytetarëve, pasi 80% e tyre i përgjigjen pozitivisht pyetjes lidhur me mekanizmat që përdor Këshilli për matjen e kënaqësisë së qytetarëve dhe po 80% e këshilltarëve raportojnë se nuk ka patur ankesa në lidhje me pjesëmarrjen qytetare në konsultimin publik. Vetëm 10% e tyre përgjigjen që ka patur ankesa, por nuk kanë dijeni në lidhje me procedurën e ndjekur, pasi sipas tyre ankesat janë përgjegjësi e Sekretarit të Këshillit Bashkiak.
- Në Këshillin Bashkiak Durrës vërehet mungesë e rolit aktiv të tij në proceset vendimarrëse, por gjithashtu dhe mungesë të raportimit nga bashkia për transparencën e proceseve vendimarrëse. 80% e këshilltarëve të intervistuar shprehin se KB nuk miraton raporte vjetor të hartuara nga Bashkia për transparencën e proceseve vendimarrëse.
- Nga përgjigjet vërehet se 60% e këshilltarëve raportojnë se janë të aftë dhe shumë të aftë për realizimin e proceseve të konsultimit publik, ndërsa 40% e këshilltarëve sugjerojnë se kanë nevojë të rrisin njohuritë në lidhje me këto procese.
- Të gjithë këshilltarët e pyetur mendojnë që RAT ka patur ndikim pozitiv e të ndjeshëm për zbatimin e mekanizmave për angazhimin qytetar dhe konsultimin publik, por rendisin një sërë sfidash që lidhen me angazhimin dhe konsultimin me publikun, disa nga të cilat janë si më poshtë:
 - Indiferenca dhe apatia qytetare, por dhe pakënaqësia e publikut nga qeverisja vendore;
 - Mungesa e informacionit të saktë nga ana e qytetarëve për kompetencat e bashkisë dhe këshillit bashkiak dhe afatet ligjore për zgjidhjen e problematikave
 - Mungesa e infrastrukturës, burimeve financiare, materiale e njerëzore
- Të pyetur për nevojat që KB ka për përmirësimin e proceseve të konsultimit, theksohet ndjeshëm rritja e bashkëpunimit bashki-këshill bashkiak-komunitet, por edhe bashkëpunimi mes forcave politike në këshill, rritja e kapaciteteve si të anëtarëve të këshillit por edhe të stafit të bashkisë. Ndër nevojat e tjera që ata listojnë si të rëndësishme mund të përmendim:
 - Rritje e gjithëpërfshirjes qytetare në procese të konsultimit publik, e sidomos aktivizim nga shoqëria civile;
 - Rritje të transparencës dhe mirëorganizim të procesit të BP



**Përmirësimi i Procesit të
Buxhetimit të Konsultuar
dhe me Pjesëmarrje**

**Improvement of Consulted and
Participatory Budgeting Process**